

RAPORTI VJETOR 2019

Përgatitur për

MBLEDHJEN E XII-të TË KUVENDIT TË STIKK



03 mars, 2020



Ora 10:00 në 14.00

Anëtarët e artë 2019/2020



Anëtarët e argjenditë 2019/2020





BUSINESS LEADS: 10 GRUPE PUNUESE: 6

B2B TAKIME: 5

**KONFERENCA &
PANAIRE: 5**

**TRAJNIME: "INFORMATION SECURITY"
"BIG DATA ANALYSIS & BUSINESS INTELLIGENCE"**



**PUBLIKIMET
IT BAROMETER
INTERNET PENETRATION**

PËRMBAJTJA

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....	4
Publikimet gjatë vitit	4
Mbledhjet e bordit	4
Stafi i STIKK	5
Anëtarët e STIKK.....	5
Të hyrat dhe shpenzimet.....	5
Auditimi i financave të STIKK.....	5
AKTIVITETET	6
Objektivi 1. Zhvillimi i një mjedisi të favorshëm për mbështetjen e rritjes së përshpejtuar të sektorit të TIK	6
Objektivi 2. Zhvillimi i burimeve njerëzore në pajtueshmëri me nevojat e sektorit të TIK-ut.....	7
Objektivi 3. Ofrimi i shërbimeve për anëtarë me qëllim të krijimit të mundësive të reja biznesore	8
Objektivi 4. Krijimi i kushteve për veprimtari të qëndrueshme të STIKK-ut.....	14
Objektivi 5. Mbështetja e anëtarëve në ushtrimin e përgjegjësisë sociale në sektorin e TIK	14
TË HYRAT DHE SHPENZIMET	15
Të hyrat	15
Shpenzimet.....	15
MBLEDHJET E BORDIT	17

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Gjate periudhës së njëvjeçare të vitit 2018 janë realizuar aktivitete të cilat janë në përputhshmëri me pesë (5) objektivat e STIKK:

- **Objektivi 1.** Zhvillimi i një mjedisi të favorshëm për mbështetjen e rritjes së përsheptuar të sektorit të TIK
- **Objektivi 2.** Zhvillimi i burimeve njerëzore në pajtueshmëri me nevojat e sektorit të TIK-ut
- **Objektivi 3.** Ofrimi i shërbimeve për anëtarë me qëllim të krijimit të mundësive të reja biznesore
- **Objektivi 4.** Krijimi i kushteve për veprimtari të qëndrueshme të STIKK-ut
- **Objektivi 5.** Mbështetja e anëtarëve në ushtrimin e përgjegjësisë sociale në sektorin e TIK

Nën objektivin e parë të strategjisë së STIKK janë ndërmarr aktivitete të cilat mbështesin rritjen e sektorit të TIK. Disa nga aktivitetet me ndikim më të madh në sja të objektivës janë: *Kontributi aktiv në grupet punuese për zhvillimet vendore, Bashkëpunimi i me regjinin e RUHR- Gjermani për zhvillimin dhe mbështetjen e Kompanive dhe Startup të Kosovës, si dhe Prezantimi publik i Barometrit të TI-së 2019.*

Nën objektivin e dytë, zhvillimi i burimeve njerëzore ose zhvillimi i fuqisë punëtorë në TIK është njëra prej shtyllave kryesore për një rritje të qëndrueshme të sektorit. Disa nga aktivitetet për këtë vit janë: Zhvillimi i Hulumtimit mbi shkathtësit e TIK-ut në sektoret tjera, *Mbarëvajtja e praktikës profesionale me mbështetje financiare, si dhe trajnimet e avansuara në bazë të nevojave të anëtarëve të STIKK.*

Objektivi i tretë ku caku është krijimi dhe zhvillimi i mundësive biznesore për anëtarët duke fuqizuar dhe zgjeruar rrjetin biznesor të tyre. Disa prej aktivitete që mbështesin këtë objektivë janë: B2B Me Liderë të Bizneseve nga ShBA, B2B Lokale me Shoqata e përpunuesve të Drurit të Kosovës, The Next Web Conference, Smart Cities New York, Kongresin Business Digital Messe, Dmexco Konferenca, *si dhe Oganizimi i edicionit të 8-të të KosICT.*

Objektivi i katërt ku krijimi i kushteve për veprimtari të qëndrueshme u mbështet nga këto aktivitete: *Kuvendi i X-të i STIKK, si dhe aplikimi dhe aprovimi i projekteve në thirrje të ndryshme.*

Objektivi i pestë - mbështetja e anëtarëve në ushtrimin e përgjegjësisë sociale në sektorin e TIK u mbështet nga ky aktivitet: *Dhurimi vullnetar i gjakut.*

Publikimet gjatë vitit

- Studimi "IT Barometer Kosovo 2019":
<https://stikk.org/wp-content/uploads/2020/01/IT-Barometri-2019.pdf>
- Studimi "Përdorimi dhe Penetrimi Internetit në Kosovë":
https://stikk.org/wp-content/uploads/2019/11/STIKK_IK_Report_Internet_Penetration_V3-final-1.pdf

Mbledhjet e bordit

Gjatë vitit 2019 u mbajtën gjithsej **8 mbledhje të Bordit** të STIKK, 4 të rregullta (23 janar, 2 maj, 17 shtator, dhe 21 nëntor) dhe 4 të jashtëzakonshme (5 shkurt, 19 mars, 13 qershor, 10 tetor).

Stafi i STIKK

Gjatë periudhës janar - dhjetor 2019, janë bërë disa ndryshime në stafin e STIKK:

STIKK ka angazhuar 4 punonjës të ri: 1 në mars (Visar Dema në pozitën e Dizajnerit Grafik), 1 në prill (Dominik Deda si Menaxher i Projekteve dhe Marketingut), 1 në qershor (Art Navakazi si Menaxher i Projekteve) dhe 1 në korrik (Blerina Rexhaj Dreshaj si Menaxhere e Administratës dhe Financave). Në vitin 2019 ju ka përfunduar kontrata 2 punonjësve: 1 në prill (Bardh Vokshi, pozita Asistent i Projekteve), 1 në qershor (Hana ahmeti, pozita Menaxhere e Financave dhe Administratës) dhe Egzon Gashi, në gusht, ka dhënë dorëheqje nga pozita e Menaxherit të Projekteve. Në qershor, nga pozita paraprake STIKK ka avancuar 1 punonjëse, Kaltrina Beha, nga pozita Asistente e Financave dhe Administratës në Junior Menaxhere të Financave dhe Administratës.

Gjithashtu, STIKK gjatë këtij viti ka angazhuar 1 praktikant në tetor, Aulona Gashi në zyre të Menaxhimit të Projekteve.

Anëtarët e STIKK

Gjatë këtij viti janë bërë **12** anëtarësime të reja në STIKK: Petrotek (*shkurt 2019*), Shkolla Digjitale (*mars 2019*), Sonnecto (maj 2019), Verpura (maj 2019), Trudo (gusht 2019), Altimaverso (tetor 2019), Evonem (tetor 2019), Bbros LLC (nëntor 2019) si anëtarë të Bronztë, Polymath (tetor 2019) dhe Prosperoware (nëntor 2019) si anëtare të Argjendtë, si dhe Cactus Education (prill 2019) dhe Proed Academy (maj 2019) si anëtare bashkëpunues. **7** kompani janë terhequr nga anëtarësimi në STIKK në 2019: Docman, Entermedia, Zetta Technologies, Ornio, Infosoft Systems, Adaptech, Translation Centre. Në fund të vitit, STIKK ka në total **58 anëtarë** (48 kompani anëtare, 9 anëtarë bashkëpunues, 1 profesionist/student).

Të hyrat dhe shpenzimet

Gjatë vitit 2019, të hyrat e STIKK ishin **327,273.36€** (54.94% më shumë krahasuar me 211,231.23 € të vitit 2018), ndërsa shpenzimet kapin shumën prej **311,968.26€** (34.61% më shumë krahasuar me 231,751.92 € në vitin 2018).

Auditimi i financave të STIKK

Kompania audituese e pavarur "Grant Thornton", e përzgjedhur nga anëtarët e STIKK në Mbledhjen e Kuvendit 2019, do të bëjë auditimin e të gjitha transaksioneve dhe procedurave financiare të STIKK për periudhën 1 janar - 31 dhjetor 2019. Ky auditim do të realizohet gjatë muajit Janar-Shkurt.

AKTIVITETET

Objektivi 1. Zhvillimi i një mjedisi të favorshëm për mbështetjen e rritjes së përsheptuar të sektorit të TIK

KONTRIBUTI AKTIV NË GRUPET PUNUESE PËR ZHVILLIMET VENDORE

Përfaqësues nga STIKK ishin pjesë aktive e grupeve punuese, që mënyrë që të ofrohen inputet për ccështjet relevante dhe ato që ndërlidhen me zhvillimin e sektorit të teknologjisë informative. Pjesëmarrja në këto grupe punuese kishte për qëllim edhe promovimin e punës së anëtarëve, ku secili dha kontributin e tyre në ccështje specifike si ndryshimet legislative, zhvillimi i kurrikulumeve dhe STIKK ka dhënë kontributin e saj në shtyrjen përpara të agjendave që çojnë drejt zhvillimit të setorit të TI të Kosovës. Në këtë drejtim, gjatë këtij viti STIKK dhe anëtarët e saj ishin pjesë e: Grupit punues për hartimin e Projektligjit për Inovacion dhe Ndërmarrësi (MIN), grupit mbi hartimin e Projektligjit për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara në transaksionet elektronike, Këshillit Kombëtar për Inovacion dhe Ndërmarrësi (MIN), Grupit Drejtues për të Dhëna të Hapura (MAP), Forumi i Zhvillimit të Politikave Industriale (MTI), Këshilli profesional i standardizimit (MTI). Gjatë këtyre takimeve u diskutuan disa pika, ndër të cilat ishte edhe aprovimi i iniciativës për transformimin e Këshillit në Koalicion Digjital, Koalicion ky i cili do të ngris qështjen e domain'it të veçant të Republikës së Kosovës. Qeveria e Kosovës poashtu mbështeti fuqishëm iniciativën për tu fokusuar në projekte inovative dhe për të ofruar ndihmën e nevojshme.

Përpos përfshirjes në grupet e lartpërmendura punuese, STIKK ishte angazhuar mjaft shumë edhe në takimet e njëpasnjëshme me donatorët për përfitimin dhe zhvillimin e projekteve, si dhe me palët tjera me interes, drejt zhvillimit të një ambienti të përshtatshëm biznesor për anëtarët.

VIZITA INFORMATIVE NË REGJIONIN RUHR - GJERMANI (05 – 09 MARS)

STIKK, në bashkpunim me GIZ dhe ICK, si dhe me përkrahje të konsulentëve të PEM, ka organizuar delagacionin i cili udhëtoi në regjionin RUHR të Gjermanisë (Düsseldorf, Dortmund, Essen dhe Kleve) për të hulumtuar tregun për partner potencial dhe për tu takuar me institucione dhe kompani të ndryshme si: networker-NRW (rrjetet e kompanive të TIK-ut); Economic Development Agency of Dortmund; Technology Center Dortmund; Business Angels Netëork Deutschland; etj. Gjatë kësaj vizite, u përforcuan raportet në mes të STIKK dhe netëorker-NRW dhe u diskutuan mundësi të ndryshme të bashkpunimit në mes të anëtarëve të STIKK dhe atyre të netëorker-NRW dhe aktivitetet e ndryshme B2B si në Gjermani poashtu edhe në Kosovë.

PREZANTIMI PUBLIK I BAROMETRIT TË TI

STIKK ka organizuar ngjarjen për shpalosjen e të gjeturave të IT Barometer 2019 para anëtarëve dhe të ftuarve, ku pastaj kishte diskutim për fokusin e sektorit të TIK për vitet e ardhshme dhe të gjeturat e raportit.

Pas prezantimit dhe diskutimit, të ftuarit u bashkuan për një koktej rasti dhe ndanë idetë e tyre për barometrin dhe si ta formojmë të ardhmen e Kosovës në sektorin e TIK.

Objektivi 2. Zhvillimi i burimeve njerëzore në pajtueshmëri me nevojat e sektorit të TIK-ut

ANALIZA E TREGUT PËR SHKATHTËSITË E TIK NË SEKTORËT E TJERË (SKILLS GAP)

Me qëllim që të ofrohet një pasqyrë reale e tregut dhe kërkesave të nevojshme për shkathtësitë e kërkuara nga profesionistët e TI në sektorët tjerë, gjatë vitit 2019 është bërë zhvillimi i hulumtimit të nevojave të tregut Kosovar për këto shkathtësi. Për të bërë këtë hulumtim është përzgjedhur një kompani e cila gjatë vitit 2019, me sygjerimet dhe inputet e STIKK ka zhvilluar pyetësorin me të dhënat cilësore dhe kuantitative. Gjithashtu janë identifikuar edhe subjektet që do të jenë pjesë e këtij hulumtimi dhe këtyre pyetësorëve. Pas rishikimit të të gjeturave nga hulumtimi dhe analizimit të të dhënave, do të publikohen gjetjet e hulumtimit dhe do të bëhet plani për adresimin e kërkesave për shkathtësitë e nevojshme të TIK në sektorët tjerë, e cila ndihmon shumë në zhvillimin e kapaciteteve të sektorëve tjerë në përdorimin e TI duke eliminuar zbraztirat eventuale që mund të kenë kompanitë sa i përket TI dhe në këtë mënyrë t'iu lehtësohet mënyra e të bërit biznes si në vend ashtu edhe në shtetet tjera.

Gjithashtu nga ky hulumtim pritet që të reduktohet deri në një masë mospërputhja e aftësive të kërkuara në tregun e punës dhe aftësive që posedon fuqia punëtore e TIK në Kosovë dhe të bëhet përputhshmëri e programeve të edukimit me nevojat e kompanive për shkathtësi të TIK.

OFRIMI I MUNDËSIVE PËR PRAKTIKË PROFESIONALE TEK KOMPANITË ANËTARE TË STIKK

Në kuadër të projektit me GIZ gjatë vitit 2019 iu mundësua kompanive anëtare të STIKK që të kenë 31 praktikantë në një periudhë 4 mujore, ku u mbështetn financiarisht për 3 muaj për secilin kandidat nga ky project. Si rezultat i këtij bashkëpunimi disa nga kompanitë anëtare angazhuan 10 nga praktikantët me orar të plotë të punës. Me këtë dëshmohen përpjekjet e vazhdueshme të STIKK që të ndërtohen kapacitetet e nevojshme për kompanitë anëtare.

“INFORMATION SECURITY TRAINING” (12 - 27 MARS) TRAJNIMI I AVANCUAR #1

Në kuadër të STIKK Education, gjatë periudhës 12 – 27 Mars është mbajtur trajnimi lidhur me temat “Information Security” dhe “Advanced Information Security” me përkrahje të GIZ përmes projektit Creating Employment Through Export Promotion (CETEP). Trajnimi është mbajtur nga trajnerët Dr. George Sharkov (National Cybersecurity Coordinator in Bulgaria), Yavor Papazov (Technical Manager në CyResLab) dhe Martin Georgiev (Computer Networks and CyberSecurity Expert në CyResLab).

“BIG DATA ANALYSIS” (16-17 DHJETOR) TRAJNIMI I AVANCUAR #2

Në kuadër të trajnimeve të avancuara të cilat STIKK i ofron për anëtarët e vet, më 16-17 Dhjetor është mbajtur trajnimi Big Data Analysis ku trajnerr ishte Philipp Freytag Von Loringhoven-Drejtor i Data Consulting në TOWA Gjermani. Trajneri ishte pjesë e edicionit të 8 të KOCIT dhe gjithashtu në këtë trajnim ndau me të pranishmit përvojën e tij dhe ofroi një workshop në të cilin të pranishmit patën mundësi të kuptojnë dhe të përdorin BIG DATA gjatë procesit të vendimmarrjes.

INICIATIVA “BRIDGE” PJESËMARRJA NË TAKIME DHE DHËNIA E REKOMANDIMEVE PËR PËRMIRËSIM TË KURRIKULAVE TË ARSIMIT TË MESËM DHE TË LARTË

Me Rektoratin e Universitetit të Prishtinës janë mbajtur 2 takime, ku pjesëmarrës ishin edhe kompanitë anëtare të STIKK. Nga këto dy takime ka dalë edhe Iniciativa "Bridge" përmes të cilës veqse është mbajtur një punëtori e udhëhequr nga kompania ABC Softëare Development në hapësirat e FIEK - Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike. Iniciativa “Bridge” është krijuar me qëllim që të thellohet bashkëpunimi në mes të institucioneve arsimore dhe sektorit privat në fushën e TIK-ut, që studentëve të kësaj fushe t’i ofrohet një pasqyrë reale e nivelit të punës dhe shërbimeve të cilat ofrohen nga kompanitë lokale të TIK-ut.


ZHVILLIMI I SEKTORIT TË TI NË KOSOVË - “LET’S TALK ABOUT THE ECONOMY”

Në krah të fushatës "Të Flasim për Ekonominë" nga Zyra e Bashkimit Europian në Kosovë dhe Europe House, më 12 Qershor është mbajtur një diskutim në formë të tryezës së rrumbullakët, ku tema ishte zhvillimi i sektorit të TI-së në Kosovë. Diskutim u moderua nga drejtori ekzekutiv i Innovation Centre Kosovo z. Uranik Begu, ndërsa pjesë e panelit ishin: Riccardo Serri - zëvendës-shëf i zyrës së BE-së në Kosovë, Vjollca Çavolli - drejtore e ekzekutive e STIKK, Leonora Kusari - përfaqësuese nga BERZH dhe Driton Hapçiu - anëtarë i bordit të drejtorëve në Cactus Sha. Ndër temat të cilat u diskutuan në këtë tryezë të rrumbullakët ishin potenciali i sektorit të TI-së, niveli i edukimit të fuqisë punëtore të sektorit, tërheqja e investitorëve të huaj në fushën e TI-së në Kosovë, qëndrueshmëria e projekteve dhe granteve të BE-së të dedikuara për sektorin e TI-së.



TAKIMI ME MINISTRIN E INOVACIONIT, Z. BESIM BEQAJ PËR MUNDËSI PUNËSIMI

Më 14 Qershor, Ministri i Inovacionit dhe Ndërmarrësisë z. Besim Beqaj ka vizituar zyret e STIKK dhe ka mbajtur një takim me përfaqësues të kompanive anëtare ku është diskutuar për problemet e ndryshme me të cilat ballafaqohet sektori i TIK-ut gjatë të bërit biznes. Një nga temat kryesore që u diskutuan gjatë takimit kishte të bënte me punën praktike të financuar nga Ministria e cila do ta fuqizonte fuqinë punëtore të kompanive të TIK-ut.



Objektivi 3. Ofrimi i shërbimeve për anëtarë me qëllim të krijimit të mundësive të reja biznesore


ORGANIZIMI I B2B ME LIDERË TË BIZNESEVE NGA SHBA (12 MARS)

Në koordinim me Konsullin e Përgjithshëm të Republikës së Kosovës në Nju Jork, znj. Teuta Sahatqija, STIKK në muajin Mars ka organizuar takimin në mes të udhëheqësve të bizneseve Amerikane dhe anëtarëve të STIKK në përpjektje për të krijuar lidhje ekonomike në mes të SHBA dhe Kosovës. Gjatë këtij takimi, kryetarja e bordit të STIKK znj. Donjeta Sahatçiu mbajti një prezantim ku u shpalosën kapacitetet e kompanive Kosovare si dhe mundësitë e bashkpunimit me bizneset Amerikane.



ORGANIZIMI I B2B LOKALE ME SHPKD (SHOQATA E PËRPUNUESVE TË DRURIT TË KOSOVËS) (27 MARS)

STIKK, në bashkpunim me SHPKD organizoi një takim B2B lokale me qëllim të njoftimit në mes të kompanive të këtyre dy sektoreve. Gjatë takimit, anëtari i bordit të STIKK z. Darsej Rizaj mbajti një prezantim të shkurtër ku u paraqitën kapacitetet dhe mundësitë e bashkpunimit në mes këtyre dy sektoreve. Gjatë takimit u diskutua edhe për problemet e ndryshme që anëtarët e SHPKD'së përballen dhe ide të ndryshme për ti zgjidhur këto probleme me ndihmën e anëtarëve të STIKK.



UDHËTIMI NË HOLANDË – “THE NEXT WEB CONFERENCE”

Më 9 dhe 10 Maj, STIKK së bashku me përfaqësues nga 7 kompanitë anëtare Frakton, Hallakate, Kutia, LinkPlusIT; Tech Frame; Coda.Tech dhe Sogody kanë marrë pjesë në konferencën The Next WEB të mbajtur në Amsterdam, Hollandë.

The Next WEB është konferencë e cila çdo vit mbledh më tepër se 17.500 profesionist të fushës së TIK-ut dhe mbi 400 folës nga kompanitë më të njohura botërore dhe ekspert të fushave të ndryshme për të diskutuar, parashikuar dhe shpikur teknologji të reja të cilat do ti ndihmonin shoqërisë në një mënyrë apo tjetër.

Pjesëmarrja në TNW Conference 2019 ishte pjesë e projektit “Transformimi Digjital i Ekonomisë Kosovare” i përkrahur nga Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë të Republikës së Kosovës.



PËRFAQËSIMI NË SMART CITIES NEW YORK

Më 13 Maj, në New York të Shteteve të Bashkuara të Amerikës është mbajtur konferenca ndërkombëtare Smart Cities Neë York, konferencë kjo e cila është ndër më të mëdhatë në Amerikën Veriore, ku mbledhen inovatorët dhe vendimmarrësit të cilët janë duke e përmirësuar jetesën në qytetet e së nesërme.

Smart Cities New York në edicionin e 3-të iu dha mundësi drejtuesve të qyteteve, përfaqësuesëve nga kompani të ndryshme të sektorit të TIK-ut dhe StartUp-ëve për të diskutuar rreth teknologjive së fundit, të cilat kanë të bëjë me përmirësimin e kushteve të jetesës nëpër qytete duke i transformuar ato në më të jetueshme, të barabarta dhe të qëndrueshme.

Në këtë konferencë të pranishëm ishin edhe një delegacion nga Kosova i cili përbëhej nga STIKK dhe përfaqësues nga kompanitë anëtare Manaferra; Cactus; LinkPlus IT; Financial Core; Frakton; Tech Frame; Inet; Sonnecto, si dhe Innovation Centre Kosovo së bashku me përfaqësues nga DataEis; Gjirafa.com; Cyberlance; Skins Agency dhe Zombie Soup. Poashtu pjesë e delegacionit ishin edhe përfaqësuesit nga Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë; Ministria e Tregtisë dhe Industrisë - MTI; Konsulata e përgjithshme e Kosovës në Neë York ; Kosovo Investment and Enterprise Support Agency - KIESA dhe American Chamber of Commerce in Kosovo - Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë.

Pjesëmarrja në Smart Cities New York ishte pjesë e projektit “Transformimi Digjital i Ekonomisë Kosovare” i përkrahur nga Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë të Republikës së Kosovës. Poashtu, një faleminderim i veçantë shkon për USAID Kosovo dhe Sida - Styrelsen för Internationellt Utvecklingssamarbete për mbështetjen e tyre përmes projektit Empoëer Private Sector Kosovo.



LEIPZIG – PJESËMARRJA NË KONGRESIN BUSINESS DIGITAL MESSE

Më 17 Maj, në Leipzig të Gjermanisë është mbajtur panairi dhe kongresi Business Digital Messe, ku të pranishëm ishin edhe përfaqësues nga STIKK dhe kompanitë anëtare Manaferra; LinkPlus; Frakton; Tech Frame; Kutia; Coda.Tech; StarLabs dhe designvox.



Në këtë panair, delegacioni nga Kosova kishte shtandin e tij ku edhe promovuan shërbimet e ofruara para vizitorëve të panairit. Ndër aktivitetet tjera të cilat e veçojnë këtë vizitë në Leipzig përfshihen: prezantimi "Kosovo - An Agile Partner for Digital Business"; takime të shumta në mes kompanive Kosovare dhe atyre Gjermane në panair, si dhe takime të formatit "speed dating" me shumë kompani Gjermane.

PËRFAQESIMI I KOSOVËS NË KONFERENCËN DMEXCO

Më 11 dhe 12 shtator, në Koln të Gjermanisë është mbajtur panairi dhe konferenca DMEXCO ku STIKK së bashku me përfaqësues nga 7 kompani anëtare dhe një delegacion të start-ups të përzgjedhur nga ICK-ja kanë qenë pjesëmarrës.

DMEXCO është njëri ndër panairët dhe konferencat më të mëdha në botë për Marketing Digjital, me më shumë se 1000 nga kompanitë më të mëdha të TIK-ut si: Facebook, Google, Microsoft, Salesforce, Tëitch, Blizzard, etj. të ekspozuara në këtë event. Përgjatë dy ditëve, përfaqësuesit nga kompanitë anëtare AdaptivIT, ArtHoues, LinkPlus IT, Hallakate, Coda.Tech, Frakton dhe Kutia kishim mundësinë të takohen me klient egzistues dhe potencial and të dëgjojnë dhe mësojnë nga fjalimet e disa prej emrave më të rëndësishëm në industrinë e TIK-ut.

Pjesëmarrja në DMEXCO është mundësuar nga Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë dhe përkrahur nga GIZ.




NJË MUNDËSI UNIKE PËR ZHVILLIM AKADEMIK DHE REKRUTIM - CODING ACADEMY NGA EPITECH BALKANS

Epitech është njëri ndër institucionet e arsimit të lartë më të njohura në Europë i cili ofron drejtime të ndryshme të specializuara në fushën e TIK-ut dhe që rishtazi ka hapur kampusin e tyre të ri në Tiranë, Shqipëri. Përfaqësues nga Epitech, në bashkpunim me STIKK, kanë mbajtur një prezantim për të gjitha kompanitë anëtare të STIKK ku prezantuan formatin e studimeve, mundësitë e ndryshme të financimit të studimeve, kurikulat e drejtimeve të ndryshme dhe rëndësinë e të qenit i diplomuar nga Epitech në tregun e punës.

Kësaj rradhe, fokusi ishte në programin “Coding Academy by Epitech”, një program 18 javor i mësimit intensiv dhe të paktën 4 javë praktikë pune në kompani të TIK-ut para çertifikimit. Pilot programi është i hapur për 20 student nga Kosova, ku 10 prej tyre do të sigurojnë bursa të plota të studimit.

Për më shumë informata rreth Epitech Balkans vizitoni: www.epitech.al



24-25 tetor 2018

ORGANIZIMI I EDICIONIT TË 8-TË TË KONFERENCËS SË TEKNOLOGJISË - KOSICT

STIKK edhe gjatë vitit 2019 organizoj konferencën e teknologjisë KOSICT, në sheshin Zahir Pajazati dhe Kino Armata në Prishtinë, më 24 dhe 25 Tetor. Të gjitha temat që u diskutuan nuk ishin vetëm nga vendasit, por edhe nga ekspert regjional dhe internacional – të cilët ndanë me të gjithë pjesëmarrësit njohuritë dhe eksperiencat e tyre për teknologjinë më të re së bashku me trendet e ndërmarrësisë nga bota e IT dhe profesionalizmin e tyre në degët e ICT-së. Disa nga temat që ishin pjesë e këtij edicioni janë: Outsourcing, FinTech, eHealth, Big Data, Rëndësia e Digitalizimit, Design Thinking, Rëndësia e Brendimit, Edukimi në IT, etj. Vëndngjarja ishte e ndarë në 3 seksione. Skena kryesore e Kino Armatës ku u mbajtën të gjitha prezantimet kryesore dhe panelet e diskutimit, ku pjesëmarrësit patën rastin të jenë pjesë e sesioneve lidhur me fushat e tyre të interesit. Dev Stage, ku pjesëmarrësit patën rastin të ndëgjojnë prezantime me teknike nga folesit e huaj dhe vendore në temat si, Amazon WEB Services, Internet of Things, Java Development, Trendet e Digital Solution, etj. Gjithashtu KosICT ka qenë nikoqir i Panairit të Inovacionit dhe Startupeve të ICK-së, ku 16 startup-a të ndryshëm kanë pasur mundësinë që të ndajnë projektet dhe idetë e tyre. Përveç kësaj mundësie, KosICT ka ofruar Business Lounge, si një vend i veçantë për të gjithë investitorët, Drejtorët dhe anëtarët në pozita të larta në kompani.

Dita e parë:

CEREMONIA HAPËSE KosICT 2019 u hap zyrtarisht nga Kryetarja e Bordit të STIKK, Znj. Donjeta Sahatciu e cila i uroj mirëseardhje dhe i përshëndeti të gjithë të pranishmit, duke theksuar punën e pandalshme dhe dedikimin e STIKK-ut dhe kompanive të sektorit të TIK-ut në Kosovë.

Hapja zyrtare e KosICT vazhdoi me Ambasadorin Gjerman në Kosovë Z. Christian Heldt, i cili i inkurajoi të rinjtë që të qendrojnë të motivuar dhe të punojnë shumë në zhvillim të karrierës së tyre në sektorin e TIK-ut, duke zhvilluar edhe një të ardhme më të mirë për ata dhe gjithë Kosovën. Pas Ambasadorit, përfaqësuesi i USAID Emponer Z. Mettheë Cullinane mori fjalën dhe premtoi përkrahjen e sektorit të TIK-ut, në veçanti për projekte të mëdha.

PREZENTIMI HAPËS Edicioni 2019 i KosICT-së sjelli shumë folës me prejardhje të ndryshme, ku të gjithë shprehën energji dhe entuziazëm për këtë event.

Një nga folësit ishte Iva Matasic ku ndau me ne pervojen e saj te gjate ne kompani te ndryshme te ICT ne Kroaci dhe njoftoj pjesemarrësit se sa premtuese janë kompanitë në Kosovë. Megjithatë, gjëja e përbashkët që këto kompanive u mungon është njohuria se si të zhvillohen tutje. Pas përfundimit nga Moderator i KosICT, dita e parë e konferencës kishte mbaruar, megjithatë, të gjithë partnerët tanë, folësit dhe të pranishmit patën rastin të shijojnë ushqimin dhe pijet jashtë në këndin e 'Business lounge' duke shijuar gjithashtu shoqërinë e njëri-tjetrit. Ky kënd mundësoi pjesëmarrësit e sektorit të TIK-ut të kenë takime jo-zyrtare që prezantojnë mundësi për rrjetëzim.

Në ditën e dytë shumë folës, mysafir, vullnetarë, dhe pjesëmarrës ishin prezent. KosICT ua mundësoi edhe njerëzve që nuk ishin prezent të merrnin informata për zhvillimin e këtij programi, duke postuar drejtpërdrejtë në rrjete sociale.

MAIN STAGE Folës nga Silbury Group, We Exist, TOWA, Novartis, VAG Nurenberg, Valtech Sweden, BASSCOM, Siemens Healthineers, Uber Media, Epitech ishin pjesëmarrësit kryesorë të dy ditëve të konferencës.

KËNDI I INOVACIONIT Gjatë dy ditëve të konferencës, përfaqësuesit e startup-ëve arritën të tregojnë dedikim dhe pasion në ndërmarrësi. Këta ndërmarrës të rinj gjatë gjithë kohës prezantuan idetë e tyre tek investitorët, folësit dhe tek publiku i gjerë. Këndi i Inovacionit pati gjithsej 16 startup dhe hyrja ishte falas për të gjithë ata që treguan interesim në lidhje me inovacionin.

FUTURE DEVELOPERS Për dalim nga vitet e kaluara, në këtë edicion të KosICT pati edhe risi tjera, ku në ditë e parë u organizua këndi i fëmijëve "Future Developers" garë kjo për fëmijët e moshës 6-15 vjet, të cilët prezantuan aftësitë e tyre koduese para një publike më të gjerë. Juria e përzgjedhur nga organizatorët e KosICT vlerësoi aplikacionet e tyre dhe bëri përzgjedhjen e tri çmimeve të para.

E-GAME TOURNAMENT Në këtë edicion u rikthy si pjesë e KosICT E-Game Tournament, ku në hapsirën e KosICT së bashku me Cportal u organizua gjysëm finalja dhe finalja në lojën "League of Legends" ku morrën pjesë 32 ekipe të ndryshme nga vendi dhe rajoni. Fitues të këtij viti ishte ekipi nga Struga e Maqedonisë Veriore. Kjo garë ngjalli një interesim të jashtëzakonshëm tek të rinjtë dhe si rezultat kjo skenë do të jetë prezente edhe në edicionet e radhës së KosICT-së.

NETËT E KOSICT-SË Pas ditës së dytë KosICT organizoi një mbrëmje, ku të gjithë pjesëmarrësit patën mundësi të njoftoheshin me të gjithë folësit dhe të diskutonin temat e KosICT-së. I falenderojmë të gjithë partnerët dhe mbështetësit që na ndihmuan për zhvillimin e sektorit të ICT-së. Për të bërë Tech Festival-in edhe me atraktiv.

Objektivi 4. Krijimi i kushteve për veprimtari të qëndrueshme të STIKK-ut

25 prill 2018

KUVENDI I XI-TË I STIKK

Më 28 shkurt është mbajtur mbledhja e radhës e kuvendit të STIKK ku të pranishëm ishin anëtar të bordit të STIKK, përfaqësues nga kompanitë anëtare si dhe përfaqësues nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik dhe BERZH. Gjatë kësaj mbledhje është diskutuar dhe aprovuar raporti vjetori i STIKK për vitin 2018, u prezantua plani i punës dhe buxheti për vitin 2019, si dhe u përzgjedh kompania Grant Thorton për ti kryer shërbimet audituese për vitet 2019-2021.



STIKK APLIKON NË THIRRJE PËR PROJEKTE

STIKK aplikon në thirrje për projekte me tema të cilat synojnë ta përforcojnë rolin e TIK në Kosovë. STIKK aplikoi në këto thirrje për aplikim: GIZ CETEP (projekti: "Advancing the ICT Sector Capabilities and Competitiveness for Accessing International Markets"), në Komisionin Evropian (projekti: Erasmus for Entrepreneurs në konsorsium me 6 shtetet Italia, Mali i Zi, Maqedoni Veriore, Bosna dhe Hercegovina, Austri dhe Turqi), si dhe ne Western Balkans Fond (projekti: Regional Cooperation Hub). Nga këto thirrje, STIKK end nuk ka pranuar përgjigje, pasqre afati i aprovimit apo refuzimit do jete ne ne tremujorin e pare te vitit 2020.

Objektivi 5. Mbështetja e anëtarëve në ushtrimin e përgjegjësisë sociale në sektorin e TIK

14 shkurt, 10 qershor dhe 21 tetor 2019

DHURIMI VULLNETAR I GJAKUT NGA STIKK DHE ICK

Në ambientet e ICK-së u mbajt aksioni tradicional i dhurimit të gjakut, ku gjatë 14 shkurt është mbajt aksioni me moton "You're somebody's type. Donate blood. With Love!", me 10 qershor me moton "Donate Blood. Be A hero!" dhe me daten 21 tetor në kuadër të KosICT ku u shperndane bileta falas per dhuruesit e gjakut. Në aksionin për dhurimin vullnetar të gjakut morrën pjesë stafi i STIKK, ICK, përfaqësues të kompanive anëtare të STIKK, ekipet e inkubatorit të ICK-së, si dhe partnerët tanë.

TË HYRAT DHE SHPENZIMET

Të hyrat

Gjatë vitit 2019, të hyrat e STIKK ishin **322,273.36 €** (52.57 % më shumë krahasuar me 211,231.23 € të vitit 2018), dhe atë nga 4 burime të mjeteve: GIZ 2019, GIZ CETEP (2018/19), Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë (MIN - 2018/19), si dhe të hyrat nga STIKK (anëtarësia, pjesëmarrja në trajnime dhe aktivitete tjera, sponzorizimet). Detajet e të hyrave janë të prezantuara në tabelën në vazhdim:

TË HYRAT	MIN 2019	GIZ 2019	STIKK	GIZ CETEP 2018/19	TOTAL
Të hyra të tjera	0,00	0,00	0,00	0.00	0.00
Të hyra nga trajnimet	0,00	0,00	1,050.00	0.00	1,050.00
Të hyra nga zhvillimi i aktiviteteve	135,591.99	72,088.00	0.00	42,144.17	249,824.16
Të hyra nga anëtarësia	0,00	0,00	19,291.00	0.00	19,291.00
Të hyra nga shërbimet tjera	0,00	0,00	52,108.20	0.00	52,108.20
TOTALI I TË HYRAVE	135,591.99	72,088.00	72,449.20	42,144.17	322,273.36

Shpenzimet

Gjatë periudhës raportuese, shpenzimet kapin shumën prej **309,385.37 €** (33.5% më shumë krahasuar me 231,751.92 € në vitin 2018/19). Disa nga projektet nuk janë mbyllur këtë fundvit, pasi që edhe kontratat, por edhe kohëzgjatja është e ndryshme. Pasqyra e shpenzimeve në detaje është e prezantuar në tabelën në vazhdim:

SHPENZIMET	MIN 2019	GIZ 2019	STIKK	GIZ CETEP 2018/19	TOTAL
Organizimi I B2B	0.00	0.00	0.00	400.00	400.00
Promovimi I Outsorce 2 Kosova	0.00	0.00	0.00	880.00	880.00
Sherbime te promovimit dhe dizajnit	0.00	1,485.00	0.00	0.00	1,485.00
Marketingu I Integruar	6,360.00	0.00	0.00	0.00	6,360.00
Pjesemarrja ne TNW	13,182.42	0.00	0.00	0.00	13,182.42
Organizimi I trajnimeve te Sigurise	0.00	0.00	0.00	22,836.23	22,836.23
STIKK Edukimi	0.00	0.00	0.00	9,825.00	9,825.00
Kostot e trajnimeve – Big Data	0.00	28,200.006	0.00	0.00	28,200.06
KosICT 2019	18,945.05	14,897.19	23,163.01	0.00	57,005.25
Implementimi I IT Barometer	0.00	3,051.00	0.00	500.00	3,551.00
PR dhe Online marketing	0.00	1,517.09	0.00	556.00	2,073.09
Takimet	0.00	0.00	924.00	0.00	924.00
Shpenzime tjera	0.00	0.00	745.00	0.00	745.00
Prezantime & shpenzime te eventeve	0.00	0.00	420.33	62.53	482.86
Konsulencë e jashtme	0.00	0.00	3,492.80	0.00	3,492.00
Shpenzime te partnereve	0.00	0.00	3,667.00	0.00	3,667.00
Pagat e stafit	38,490.60	15,070.40	50,704.21	6,240.00	110,505.21
Transporti Lokal	0.00	201.90	304.06	75.00	580.96
Shpenzimet administrative/operacionale	6,016.73	1,255.59	8,005.07	769.41	16,046.80
Per Diem	0.00	0.00	5,062.42	0.00	5,062.42
Transport Nderkombetar per B2B	0.00	634	5,392.81	0.00	6026.81
Borxhi ndaj BE	0.00	0.00	16,053.46	0.00	16,053.46
TOTALI i Shpenzimeve	82,994.8	66,312.23	117,934.17	42,144.17	309,385.37

MBLEDHJET E BORDIT TË STIKK

Gjatë kësaj periudhe raportuese janë mbajtur 8 mbledhje të Bordit (4 të rregullta, 4 të jashtëzakonshme).

Mbledhja I: 23 janar 2019 (e rregullt)

Pikat e rendit të ditës të cilat u diskutuan gjatë kësaj mbledhjeje:

1. Diskutimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e pesëdhjetë e pestë, mbajtur me 3 tetor 2018.
2. Diskutimi dhe aprovimi i raportit tremujor (Tetor-Dhjetor 2018) të STIKK.
3. Diskutimi dhe aprovimi i raportit vjetor 2018.
4. Diskutimi i planit të punës dhe burimet e mjeteve për 2019.
5. Caktimi i datës për mbledhje të Kuvendit të XI-të.

Vendimet:

- Pika 5 të rishkruhet që të jetë më e qartë.
- Procesverbali votohet unanimisht.
- Raporti vjetor 2018 aprovohet unanimisht.
- U vendos që më 5 Shkurt të mbahet një mbledhje plotësuese për mbledhjen e datës 23 Janar.
- U vendos që të krijohet një Google Sheet përmes të cilës anëtarët e bordit të kenë mundësinë të komentojnë rreth planit të punës.
- Bordi vendosi që Kuvendi i XI-të të mbahet më datën 28 Shkurt 2019.

Mbledhja II: 5 shkurt 2019 (e jashtëzakonshme)**Pikat e rendit të ditës të cilat u diskutuan gjatë kësaj mbledhjeje:**

1. Diskutimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e pesëdhjetë e gjashtë, mbajtur me 23 janar 2019.
2. Diskutim rreth revidimit të pakove të anëtarësisë.
3. Diskutimi rreth mbarëvajtjes së edicionit të kaluar të KosICT dhe rekomandime për edicionin e 2019.
4. Diskutim rreth Barometrit të TI-së 2018 dhe rekomandime për edicionin e 2019.
5. Diskutim rreth të ardhurave të DE të STIKK.
6. Të ndryshme.

Vendimet:

- Procesverbali votohet unanimisht.
- U vendos që të krijohet një grup punues për të ardhur me ide të reja rreth revidimit të pakove të anëtarësisë.
- Për pikën 2 u votua unanimisht që të shtyhet për mbledhjen tjetër.
- U vendos unanimisht që për KosICT të organizohet një mbledhje e veçantë pas Kuvendit XI më 5 mars 2019 prej orës 14:00 tetor.
- U vendos unanimisht që të krijohet një grup punues që në bashkëpunim me donatorët të vijë me rekomandime për IT Barometrin 19’.
- Data e takimit të parë të grupit punues të jetë 15 Prill.
- Bordi vendosi unanimisht që të ardhurat e Drejtoreshës Ekzekutive të rriten për 30%.
- Bordi vendosi unanimisht që lokacioni për Kuvendin XI të jetë Garden Hotel.
- U vendos unanimisht që në Kuvendin XI të ftohen edhe përfaqësues të Qeverisë së Kosovës si dhe partnerët ndërkombëtar.

Mbledhja III: 19 mars 2019 (e jashtëzakonshme)**Pikat e rendit të ditës të cilat u diskutuan gjatë kësaj mbledhjeje:**

1. Diskutimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e pesëdhjetë e katërt, mbajtur më 14 korrik 2018.
2. Diskutimi dhe aprovimi i raportit tremujor (Korrik-Shtator 2018) të STIKK.
3. Diskutimi rreth mbarëvajtjes së konferencës vjetore KosICT.
4. Diskutimi dhe aprovimi: STIKK EPS Fund – Framework Agreement for Commission Scheme.
5. Të tjera.

Vendimet:

- Pika e dytë paragrafi i tretë të largohet nga procesverbali i mbledhjes së pesëdhjetë e katërt . Votohet me pesë vota për dhe z.Ermal Sadiku abstenon.
- Raporti për këtë tre-mujor aprovohet unanimisht me votat e të gjithë anëtarëve të pranishëm të Bordit.
- Vendoset që dokumenti i STIKK EPS Fund të i dërgohet me email bordit dhe të ipen komente deri me 07 tetor 2018.

Mbledhja IV: 2 maj 2019 (e rregullt)

Pikat e rendit të ditës të cilat u diskutuan gjatë kësaj mbledhjeje:

1. Raportim nga komiteti i ngjarjeve, duke inkuadruar propozimin për KosICT 2019.
2. Diskutim rreth propozimit për KosICT 2019.
3. Të ndryshme.

Vendimet:

- Unanimisht u votua lokacioni i propozuar Kino Armata.
- Unanimisht u votua tema kryesore e edicionit të 8-të të KosICT “Outsourcing”.
- Unanimisht u votua propozimi për panel discussions shtesë.
- Unanimisht aprovohet propozimi për organizimin e B2B Sessions.
- Unanimisht aprovohet propozimi që të organizohet gaming tournament.
- Është vendosur që StartUp Competition mos të mbahet pasi që nuk i përshtatet frymës së KosICT-së dhe po replikohen aktivitetet e ICK-së.
- Unanimisht aprovohet propozimi për Kids Coding Hackathon. Pjesëmarrësit potencial janë: Shkolla Digjitale, JCoders, Cactus Kids, Bonevet, etj. Shpërblimi i propozuar është Labbox package.
- Unanimisht aprovohet propozimi për FuckUp Nights.

Mbledhja V: 13 qershor 2019 (e jashtëzakonshme)**Pikat e rendit të ditës të cilat u diskutuan gjatë kësaj mbledhjeje:**

1. Diskutimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e 60-të, e mbajtur me 29 maj 2019.
2. Raportimi nga komitetet permanente të ngjarjeve, operativës dhe të zhvillimit.
3. Diskutimi dhe aprovimi i konceptit të identitetit vizual të KosICT edicioni 8.
4. Të ndryshme.

Vendimet:

- Procesverballi i mbledhjes se 60-të u aprovua me shumicë të votave.
- Zyra e ekzekutivit do ti përcjell vendimin tek project.graphics të cilët do ta zbërthejnë atë në elemente të ndryshme sipas nevojave të KosICT-së.
- U vendos unanimisht që në Kuvendin XI të ftohen edhe përfaqësues të Qeverisë së Kosovës si dhe partnerët ndërkombëtar.

Mbledhja VI: 17 shtator 2019 (e rregullt)**Pikat e rendit të ditës të cilat u diskutuan gjatë kësaj mbledhjeje:**

1. Diskutimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e 61-të, e mbajtur me 13 qershor 2019.
2. Raportimi i aktiviteteve dhe financave (ne vije me planin e punes) per 3 mujorin PrillQershor 2019.
3. Raportimi nga komitetet permanente te ngjarjeve, operatives dhe te zhvillimit.
4. Diskutim mbi zhvillimet e organizimit te KosICT.
5. Të ndryshme.

Vendimet:

- Maicat të cilat do ti veshin fëmijët gjatë Hackathon-it do të jeni të brenduara me elemente të KosICT, e jo shkollave që i përfaqësojnë fëmijët pjesëmarrës në Hackathon.
- Pas votimit, u aprovua dorëheqja e Bardh Kadiut nga Bordi i Drejtorëve të STIKK.
- Të krijohet një listë me planet për pjesmarrjet në udhëtimet e radhës.
- Të definohen objektivat e udhëtimeve dhe pritjet nga to në mënyrë që vendimet për pjesmarrje apo jo të bazohen në qëllimet tona.
- Të analizohet gjendja e webfaqes Outsource2Kosov nga zyra ekzekutive.
- Të shikohen analytics, content, visitors, bugs dhe mungesat dhe raporti përfshirë propozimet konkrete ti dërgohet komitetit të zhvillimit për të vendosur se si të vazhdohet tutje.
- Të shohim se a ka interesim nga kompanitë anëtare në STIKK për pjesëmarrje në WEB Summit në Lisbonë në Nëntor, 2019.
- Zyra ekzekutive të krijoj një raport ku përfshihet feedback-u nga kompanitë anëtare pjesëmarrëse në udhëtimet biznesore të organizuar gjatë 2019.

Mbledhja VII: 10 tetor 2019 (e jashtëzakonshme)**Pikat e rendit të ditës të cilat u diskutuan gjatë kësaj mbledhjeje:**

1. Diskutimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e 62-të, e mbajtur me 17 shtator 2019.
2. Prezantimi i të rejave në vijë me planin e punës (zyra ekzekutive).
3. Diskutim mbi zhvillimet e organizimit të KosICT.
4. Raportim nga komitetet permanente të ngjarjeve, operativës dhe të zhvillimit.
5. Të ndryshme.

Vendimet:

- Procesverbali i mbledhjes së 62-të u aprovua unanimisht nga anëtarët e pranishëm të bordit.
- Raporti i zyrës ekzekutive u aprovua unanimisht nga të gjithë anëtarët e bordit të pranishëm.
- Kërkesa e drejtoreshës ekzekutive për largimin e pikave në fjalë nga plani i punës u aprovua nga anëtarët e pranishëm të bordit.

Mbledhja VIII: 21 nëntor 2019 (e rregullt)**Pikat e rendit të ditës të cilat u diskutuan gjatë kësaj mbledhjeje:**

1. Diskutimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e 63-të, e mbajtur me 10 tetor 2019.
2. Prezantimi i të rejave në vijë me planin e punës.
3. Raportim mbi rezultatet dhe financat e edicionit të 8-të të KosICT 2019.
4. Diskutim mbi ngjarjen e ardhshme, publikimi i IT Barometer 2019.
5. Të ndryshme.

Vendimet:

Procesverbali i mbledhjes së 63-të u aprovua unanimisht nga anëtarët e pranishëm të bordit.

- Anëtarët e Bordit u dakorduan që KosICT nga tash e tutje ti referohemi si Festival I Teknologjisë, e jo konferencë.
- Anëtarët e Bordit poashtu u pajtuan që dy aktivitetet: Future Developers dhe eSports Tournament, pas suksesit që treguan këtë edicion, të përfshihen edhe në edicionet e radhës të KosICT.
- Kuvendi i radhës I anëtarëve të STIKK për vitin 2020 të cakohet sa më herët, të përgjidhet lokacioni ku do të mbahet takimi dhe të caktohet formati. Kërkesa nga anëtarët e bordit është që takimi mundësisht të jetë më ndryshe nga vitet e mëparshme, me prezantime konkrete të punëve të realizuara gjatë vitit 2019.
- Mbledhja e radhës e bordit u caktua të mbahet gjatë muajit janar, pas aprovimit të datave të propozuara nga Kryetarja e bordit.
- Anëtarët e bordit do të dërgojnë propozimet e tyre për planin e punës së STIKK për vitin 2020, si dhe çfarë ata presin nga STIKK për vitin e ardhshëm. Kjo do të bëhet përmes Google Docs dhe propozimet në fjalë do të përfshihen në planin vjetorë të STIKK.